

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegji, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit "[G...]" L.L.C., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës "[N...]" sh.p.k., me seli në Fsh. [...], Komuna e Pejës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.223/17, të datës, 21.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.12.12.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET tësitankesa "[G...]" L.L.C.,
PRISHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.223/17, i datës, 21.09.2017, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë IV.EK.C.nr.223/17, të datës, 21.09.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike e ka Refuzuar propozimin e propozuesit të sigurimit "[G...]" L.L.C. që kundërshtarit të sigurimit "[N...]" Sh.p.k. me seli në Pejë, t'i caktohet masa e sigurimit, tjetërsimi, ngarkimi i kapitalit aksionar në vlerë prej 1,200,000.00 €, të regjistruara në pronësinë e kundërshtarit të sigurimit, në ARBK.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi "[G...]" L.L.C., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit pas të miratojë ankesën e paditësit në tërësi dhe e prish aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike apo të njëjtin ta ndryshojë propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit i shqyrtojë shkresat e lëndës, pretendimet ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 të LPK-së, ka gjetur se:

ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi "[G...]" L.L.C. ka paraqitur padi për pagesën e borxhit respektivisht huasë kundër të paditurës "[N...]" sh.p.k., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpafia e paditësit si e bazuar dhe te detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,200.000.00 €. së bashku me kamatën ligjore si dhe t'ia

kompensojë shpenzimet e procedurës gjyqësore aq sa do të krijohen, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës së sigurisë.

Në këtë gjendje të çështjes juridike, Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsytet për faktet vendimtare respektivisht arsytet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare se si e ka krijuar bindje e saj se pala kundërshtare nuk do ta pamundësoi apo vështirësoi realizimin e kërkesës së propozuesve në rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së tyre.

Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palës propozuese për caktimin e masës siguroese, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa i vërtetuar me prova konkrete faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se propozimi i palës propozuese për caktimin e masës siguroese është i pabazuar.

Konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se propozuesi nuk ka arritur të sqarojë se për kapitalin mbi të cilin ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë, a është pasuri e paluajtshme, mjete monetare apo kapital tjetër është jorelevant në rastin konkret sepse të gjitha asetet e shoqërisë tregtare përbëjnë kapitalin e shoqërisë të shprehur në aksione ndërsa aksionet përbëjnë të drejta të aksionarëve në shoqëri e rrjedhimisht edhe në tërë asetet apo kapitalin e shoqërisë. Nëse gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se sqarimi i rrethanave përkatëse ka qenë më rendësi për vendosje, ka pasur për obligim t'i sqarojë këto rrethana e pastaj të vendos për çështjen, e jo ta refuzojë propozimin për shkak të rrethanave të pasqaruara. Është i papranueshëm edhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë se propozuesi nuk ka arritur të sqarojë regjistrimin e kapitalit në ARBK sepse regjistrat e ARBK-së përbëjnë regjistra publik të cilët gjenden në faqen zyrtare të ARBK-së, dhe kjo çështje ka mundur të sqarohet nga gjykata me ekzaminim të thjeshtë të të dhënave të shoqërisë tregtare.

Poashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për ta sqaruar se pse caktimi i masës së sigurisë do të ishte në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për shoqëritë tregtare ashtu siç ka theksuar në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, pasi nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi "[G...]" L.L.C. ka fituar cilësinë e kreditorit në raport me të paditurin në bazë të kontratës së cedimit (bartjes) së kërkesës nga Gerhard Frey. Sipas Nenit 436 të LMD-së përcaktohet se: *Kreditori mundet me kontratën e lidhur me personin e tretë ti kalojë këtij*

kërkesat e veta, me përjashtim të atyre kërkesave kalimin e të cilave është i ndaluar me ligj, si dhe i atyre që lidhen me personin e kreditorit, ose e cila nga vetë natyra e tyre nuk mund t'i bartën tjetrit". Ndërsa sipas Nenit 438 të LMD-së përcaktohet se: "Për bartjen e kërkesës nuk nevojitet pëlqimi i debitorit, por ceduesi ka për detyrë ta njoftojë debitorin mbi cedimin e bërë". Me Nenin 440 të LMD-së përcaktohet se: Pritësi ka ndaj debitorit të njëjtat të drejta të cilat ceduesi i ka pasur ndaj debitorit përpara cedimit.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitohet të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetohet faktet relevante të sipërpërmendura, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar nëse janë plotësuar kushtet nga Neni 297 par.1 i LPK-së, ashtu që pastaj, lidhur me masën e propozuar të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ae.nr.281/2017,dt. 12.12.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutuli, d.v.

